



Planuar / Dorëzuar Pritjen / Prodator Received / Delivered	29.06.2022	2	viti god. year
Organ / Njësia Organ / Jedinstva Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHTOK	3698/2022		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.445/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.445/2022 të datës 11.05.2022 e parashtruar nga ankuesja me adresë Rrugë:

kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike „kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 23.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.445/2022 e datës 11.05.2022, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja ne datë 07.09.2021 ka parashtruar kërkesë në Komisionin për Grada dhe Disiplinë pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për Gradë Diplomatike/Konsullore.

Ankuesja e pa kënaqur me mos pranimin e asnjë përgjigje nga ana e Komisionit, me datë 19.04.2022 ka parashtruar kërkesën për qasje në dokumente publike, e cila kërkesë ankueses iu është aprovuar me Vendim Nr.133/2022 të datës 22.04.2022 të Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës së Jashtme dhe Diasporës.

Ankuesja nëpërmjet e-mail-it zyrtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 11.05.2022 ka parashtruar ankesën me numër të

protokollit 2689/2022 me pretendim ankimor kundër Komisionit për Gradë dhe Disiplinë për mos dhënien e rekomandimit për gradë diplomatike apo konsullore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 19.05.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa me datë 25.05.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/26.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses e datës 11.05.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; CV e ankueses; Formulari për vlerësimin e punës provuese; Kërkesa e ankueses e datës 07.09.2021 për Komisionin për Grada dhe Disiplinë; Letër motivimi për Komisionin për Grada dhe Disiplinë; Vendimi i datës 08.03.2021 me nr.ref.62-/2021; Vërtetimi i datës 15.09.2020; Vërtetimi i datës 17.09.2020; Akt emërimi i datës 20.01.2020; Certifikata e datës 29.07.2017; Procesverbali i mbledhjes i Komisionit për Grada dhe Disiplinë e datës 08.12.2021 dhe vazhdimi i datës 10.12.2021 dhe i datës 14.12.2021; Vendimi i datës 22.04.2022; Kërkesa e datës 19.04.2022 për qasje në dokumente publikë; Akt emërimi i datës 25.09.2019; Kërkesa e datës 07.09.2021 për Gradë Diplomate/Konsullore; e-mail i datës 07.09.2021; Formulari për vlerësimin e punës provuese; Vendimi i datës 08.03.2021; Vërtetimi i datës 15.09.2020 dhe i datës 17.09.2020 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses *është e pabazuar sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka gjetur se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datë 03.09.2021 ka bërë ftesë për shprehje të interesit për gradim duke u mbështetur në nenin 30 të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm me Nr.03/L-122 duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 4 dhe nenin 14 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm kështu duke i njoftuar kandidatët se Komisioni për Grada dhe Disiplinë do të mbledhet me datë 10.09.2021 dhe se në mbështetje të kriterëve ligjor për avancim do të shqyrtoj kërkesat për gradim dhe se ankuesja me datë 07.09.2021 ka dërguar kërkesën për Grada Diplomate/Konsullore për Komisionin për Gradë dhe Disiplinë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka gjetur se Ministria e Ministrisë së Punëve të Jashtme me Vendimin me numër të referencës 471/2021 të datës 01.12.2021 ka bërë emërimin e anëtarëve të Komisionit për Gradim dhe Disiplinë prej shtatë (7) anëtarëve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës konkretisht Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit për Grada dhe Disiplinë të mbajtur me datë 09.12.2021 dhe të vazhduar me date me datë 10.12.2021 ka konstatuar se prej shtatë (7) anëtarëve të Komisionit prezent në këtë takim kanë qenë gjashtë (6) anëtarë Kryesuesja e Komisionit dhe pesë (5) anëtarë të tjerë. Gjithnjë duke u bazuar në procesverbalin e mbledhjes së datës 09.12.2021 dhe vazhdimin të datës 10.12.2021, Kolegji ka konstatuar se Komisioni për Grada dhe Disiplinë e ka shqyrtuar aplikacionin e ankueses dhe se Kryesuesja e Komisionit e ka hedhur në votim propozimin e komisionit që kandidatja të gradohet për një gradë, në gradën „Atashe” dhe pas hüdhe së propozimit në votim rezultati i votimit ishte gjashtë (6) anëtarë të Komisionit për Grada dhe Disiplinë kanë abstenuar, në procesverbal është konstatuar se nuk u miratua propozimi i Komisionit për Grada dhe Disiplinë për gradim të Andaj, lidhur me votimin Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore të nenit 42 paragrafi 1 dhe 2 i Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili ka përcaktuar se: **“1. Vendimet e organit kolegjal merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Vendimet me procedurë qarkulluese merren me shumicën e votave të anëtarëve të organit kolegjal. 2. Abstenimi apo votat e paplotësuara do të llogariten si vota kundër”**, rrjedhimisht pretendimi ankimor i ankueses që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ta detyroj Komisionin për Grada dhe Disiplinë që të bëjë rekomandimin për ankuesen për rritje të gradës është i pa bazuar sepse sipas dispozitave të lartë cekura votat e abstenuara llogariten vota kundër.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.445/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.